



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-69575/19 dt. 26.03.2019, të investitorit “Agullimi-A” Sh.P.K nga Gjakova, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës administrative, me etazhitet -2B+P+7, në rrugën “Rrahim Beqiri” dhe “Vëllezerit Gërvalla”, Lagjja “Kodra e Diellit” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 21.05.2019 lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit** pronarit Hajdin, Hysen dhe Ramadan Beka nga Prishtina, me investitorin “**Agullimi-A**” Sh.P.K. nga Gjakova me përfaqësues Zeqir Haxhija, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-69575/19 dt. 26.03.2019, për përdorimin e ndërtesës banimore me afarizëm, me etazhitet -2B+P+7, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914059-06257-2, Zona Kadastrale Prishtinë sipas Vendimit 05 nr.351-78513 dt. 14.08.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

**II.** Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-78513 të datës 14.08.2013, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

**III.** Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

**IV.** Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Pronari Hajdin, Hysen dhe Ramadan Beka nga Prishtina me investitorin “**Agullimi-A**” Sh.P.K. nga Gjakova me përfaqësues Zeqir Haxhija, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-69575/18 dt. 26.03.2019, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës administrative, me etazhitet -2B+P+7, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendim nr. 05 Nr. 351-78513 dt. 14.08.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës me etazhitet -2B+P+7 të pronarit Hajdin, Hysen dhe Ramadan Beka me investitor “**Agullimi-A**” Sh.P.K. nga Gjakova me përfaqësues Zeqir Haxhija, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 06257-2 e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-06257-2 Zona Kadastrale Prishtinë.
- Aktvendimin numër 05-351-78513 dt. 31.07.2013, mbi caktimin e taksës për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e kompleksit banimor afarist.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e kompleksit banimor afarist.
- Konstatim mbi caktimin e pikave me nr. të referencës 05-394-150281 dt.20.08.2013



- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-022762/17 dt. 26.09.2017
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes,
  - Emin Bogiqi IDA. udhëheqës i vend ndërtimit,
  - Emin Bogiqi IDA. mbikëqyrës për arkitekturë,
  - Arsim Rapuca IND. dhe Behar Gashi mbikëqyrës për Strukturë,
  - Ermal Daka IDH. dhe Naim Munishi mbikëqyrës për Hidro-Instalime,
  - Zenel Dinaj, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike,
  - Gazmend Krasniqi, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike,
  - Burim Sopaj, mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri,
  - Xhavit Gorçaj, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë,
- Protokollet e miratuara për te gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspekcionit-Sektorit i Ndërtimit përmes shkresës me numër 05 Nr.391/02-0241516/17 dt 22.03.2019 ka arritur ne Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspekcionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit së bashku me kërkesën për pajisje me certifikatë të përdorimit nga ana e investitorit, përmes shkresës 05 Nr. 391/02-69575/19 dt. 26.03.2019, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, mbrojtje nga zjarri dhe punëve zejtare, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr.351-78513 dt.14.08.2013, si dhe plotësimeve ta aprovuara nga Drejtoria e Urbanizmit. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa administrative mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspekcionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspekcionit të Ndërtimit.

**Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351-78513 të datës 14.03.2013 janë zbatuar,**

**Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,**

**Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.**

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa administrative, me etazhitet -2B+P+7, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-69575/19 DT. 21.05.2019**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Prestreshi

